



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2022

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Drejtësisë (MD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MD kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin

e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Pagesat nga subvencionet dhe transferet lidhur me mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave potencial të akuzuar pranë Dhomave të Specializuara të cilat kanë qenë të klasifikuara (niveli i kufizuar) nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zv. Sekretarja e Përgjithshme është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zv. Sekretarja e Përgjithshme është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ministria ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 30,134,916€ me një rënie prej 4% në raport me vitin 2021.

Fushat për përmirësim tek shpenzimet kanë të bëjnë me klasifikim jo adekuat të shpenzimeve si dhe vonesa në zotimin e mjeteve, po ashtu janë identifikuar edhe dobësi në menaxhimin e pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dhe dy (2) rekomandime pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja C1 - Mbivlerësim i regjistrave të pasurisë në PFV

Gjetja Sipas nenit 6 të rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore – Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.

Nga rishikimi i PFV-ve të ministrisë si dhe krahasimi i tyre me shënimet e SIMFK identifikua se vlera e pasurisë mbi 1,000€ e prezantuar tek neni 19.3.1 është e mbivlerësuar për 342,808€. Çështjet që kanë ndikuar në këtë gjendje janë si në vijim:

- Pagesa në vlerë 447,892€ për ndërtimin e objektit për dëshmitarët e mbrojtur ishte regjistruar dy herë në regjistrat e pasurisë së SHKK në vitin 2009. Rrjedhimisht, regjistrat ishin mbivlerësuar për 294,863€ sa ishte vlera neto e kësaj pasuri në fund të vitit 2022; dhe

- Përmes ankandit publik, SHKK gjatë vitit kishte shitur pasuri në vlerë prej 37,567€. Për këto pasuri të shitura si dhe për dy pasuri të cilat ishin regjistruar dyfish në vlerë 10,378€, SHKK ka përcjellur shkresë zyrtare në Thesar/MFPT për largimin e tyre nga regjistrat e pasurisë. Mirëpo, SHKK paraprakisht nuk kishte përcjellur tek MFPT kërkesën për aprovim të shitjes përmes ankandit (neni 9 pika 2 të rreg. 01-2013 shpenzimi i parasë publike) dhe për këtë arsye ishte refuzuar shkresa/kërkesa për largimin e këtyre pasurive nga regjistrat.

Regjistrimi i dyfishtë i pasurisë kishte ndodhur për shkak se në atë kohë pasuria regjistrohej përmes pagesave/transaksioneve dhe nuk ishte vërejtur nga zyrtarët përgjegjës të pasurisë. Ndërsa, mos largimi i pasurisë nga regjistri kishte ndodhur për shkak se SHKK në mungesë të njohurive nuk kishte respektuar procedurat për shitje të pasurisë, pasi që nuk është njoftuar komisioni i MFPT si dhe nuk kishte vendim nga ana e tyre.

Ndikimi Regjistrimi i dyfishtë i pasurisë si dhe mos largimi i pasurisë së shitur nga regjistrat përkatës ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurisë në PFV duke mbivlerësuar vlerën e tyre.

Rekomandimi C1 Ministrja duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm sa i përket regjistrave të pasurive si dhe në bashkëpunim me Thesarin/MFPT të sigurojë se vlera pasurive e paraqitur në PFV e vitit 2023 të jetë e saktë dhe e plotë. Po ashtu, Ministrja duhet të sigurojë që të gjitha proceset rreth tjetërsimit/shitjes së pasurive kapitale realizohen në pajtim me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime (me shpenzime komunale) në vitin 2022 ishte 8,873,434€, prej tyre ishin shpenzuar 8,145,609€. Ato kanë të bëjnë me furnizim me ushqim për nevojat e të burgosurve, shpenzime të arbitrazhit, furnizim me material shpenzues, derivate për ngrohje, veshmbathje për stafin korrektues, shërbime komunale, etj.

Çështja A1 - Vonesë në zotimin e mjeteve

Gjetja Sipas nenit 22 të rregullës financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, urdhërblerja, raporti i pranimit të mallit (pranohet malli apo shërbimi) dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në tre pagesa në vlerë totale prej 45,655€, (dy raste në Qendrën Korrektuese Dubravë, një rast në Shërbimin Sprovues të Kosovës) fillimisht kishin pranuar faturën, ndërsa zotimin e mjeteve e kishin bërë me vonesa të cilat variojnë nga 22 deri në 27 ditë. Këto pagesa ishin për furnizim me ushqim dhe derivate.

Shkaku i vonesave në zotimin e mjeteve ka ndodhur si rezultat i shpërndarjes së lokacioneve të qendrave korrektuese dhe specifikeve të natyrës së tyre.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë që ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, e të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A1 Ministrja duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregulloret në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të bëhet pranimi i mallit/shërbimit dhe faturës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,077,131€, prej tyre ishin shpenzuar 909,946€. Ato kanë të bëjnë me renovimin e objekteve të burgjeve, blerjen e pajisjeve, instalimin e kamerave në Shërbimet Korrektuese etj.

Çështja A2 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Dy pagesa në vlerë të përbashkët 19,494€ janë paguar nga kategoria e investimeve kapitale përderisa për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Njëra pagesë (në vlerë 11,584€) ishte për instalimin e kamerave, ndërsa pagesa tjetër (në vlerë 7,930€) për blerjen e pajisjeve për kontrollin e trazirave.

Kjo kishte ndodhur për shkak se SHKK këto pajisje i kishte planifikuar gabimisht në buxhetin për investime kapitale.

Ndikimi Shpenzimi i buxhetit të investimeve kapitale për mallra dhe shërbime, rezulton me një pasqyrë jo të saktë të shpenzimit në PFV, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë përkatëse.

Rekomandimi A2 Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëjë ridestinim të mjeteve sipas kategorive adekuate të shpenzimeve në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 96,527,116€, pasurive jokapitale është 475,475€, si dhe e stoqeve 536,384€.

Çështja C2 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Neni 19 paragrafi 4.3 i rregullores Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”.

Nga auditimi i menaxhimit të pasurisë në MD kemi identifikuar çështjet si në vijim:

- Përkundër që, komisionet përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë, SHKK, Agjencinë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës kishin bërë inventarizimin e pasurisë për vitin 2022, nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PFV ishte bërë sipas regjistrave kontabël; dhe

- Pasuria në vlerë neto prej 59,579€ e prezantuar në PFV nuk figuronte në sistemin e-pasuria. Kjo situatë ishte rezultat i mos bartjes së pasurisë në vlerë prej 250,780€ nga verzioni i vjetër në verzionin e ri të sistemit e-pasuria në vitin 2019. Për këtë pasuri, zhvlerësimi i akumuluar ishte përllogaritur manualisht në formë Excel-i nga zyrtari i pasurisë.

Për shkak të strukturës së shpërndarë organizative si dhe kontrolleve të brendshme jo adekuate nuk ishte kryer harmonizimi i pasurisë. Po ashtu, edhe mos marrja e veprimeve të nevojshme dhe në kohë nga zyrtarët e SHKK-së për të bërë regjistrimet e duhura në sistemin e-pasuria.

Ndikimi Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat të pasurisë dhe mos regjistrimi i një pjese të pasurisë nën 1,000€ në sistemin e-pasuria rrisin rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet.

Rekomandimi C2 Ministrja duhet të sigurojë që komisionet përkatëse pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjnë harmonizimin me gjendjen në regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve, me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen e saktë të pasurive me të cilat disponon ministria. Po ashtu, duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë nën 1,000€ janë të regjistruara në sistemin e-pasuria duke përfshirë edhe të gjitha pasuritë nga regjistrat e verzionit të vjetër të sistemit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^s	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	29,621,038	33,177,564	30,134,916	28,222,191	21,347,718
Grante Qeveritare – Buxheti	29,540,838	33,007,740	30,068,326	28,190,019	21,306,120
Financimi përmes huamarrjes	0	45,108	45,108	11,221	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,096	1,096	1,641	41,598
Të hyrat vetanake	80,200	80,200	16,406	19,310	0
Donacionet e jashtme	0	43,420	3,981	0	0

Buxheti final i Ministrisë së Drejtësisë është më i lartë se buxheti fillestar për 3,556,526€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 3,466,902€, përfshirjes së financimit nga huamarrja në vlerë prej 45,108€, të hyrave të bartura prej 1,096€, si dhe vlerës së mbetur të donacioneve 43,420€ në buxhet final.

Në vitin 2022, MD ka shpenzuar 91% të buxhetit përfundimtar ose 30,134,916€, me një ulje prej 4% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	29,621,038	33,177,564	30,134,916	28,222,191	21,347,718
Pagat dhe mëditjet	14,020,164	13,591,854	13,079,738	13,301,515	14,498,653
Mallrat dhe shërbimet	6,286,905	7,763,978	7,141,384	6,112,369	5,360,588
Komunalitë	1,053,969	1,109,456	1,004,225	1,040,780	775,129
Subvencionet dhe transferet	6,928,000	9,625,145	7,999,623	7,104,392	68,456
Investimet Kapitale	1,322,000	1,077,131	909,946	663,135	644,891
Rezervat	10,000	10,000	0	0	0

MD kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 428,310€. Kjo ishte rezultat i financimit nga huamarrja prej 45,108€, të hyrave vetanake prej 1,096€ si dhe vendimit Qeverisë nr. 04/115 dhe 06/112 për kursime buxhetore prej 474,513€. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 96% e buxhetit. Ministria këtë vit nuk kishte arritur në plotësi ta ekzekutoj buxhetin për arsye të mos plotësimit të pozitave të parapara në Ligj të Buxhetit dhe pensionimit të zyrtarëve;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,477,073€. Kjo ishte si rezultat i donacioneve të bartura në vlerë prej 43,420€, ndarjes së mjeteve me vendime të Qeverisë (nr. 22/94 dhe 06/113 dhe 14/106) prej 1,368,653€, dhe transferit të brendshëm të buxhetit nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve prej 65,000€. Ndarja e mjeteve nga Qeveria ishte bërë me kërkesë të ministrisë për mbulimin e shpenzimeve të arbitrazhit, për shkak të rritjes së rasteve në Gjykatën e Arbitrazhit. Pjesa tjetër e pashpenzuar e këtij buxheti ka të bëjë me obligimet e SHKK-së të vitit 2022 që kishin ardhur pas mbylljes së vitit fiskal. Ekzekutimi i buxhetit tek kjo kategori është 92%;


- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 55,487€. Kjo ishte rezultat i ndarjes së mjeteve me vendim të Qeverisë 14/106. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori është 91%. Pjesa e pashpenzuar e buxhetit ka të bëjë me faturat që kanë ardhur për pagesë pas mbylljes së vitit fiskal;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,697,145€. Kjo ishte rezultat i ndarjes së mjeteve prej 2,762,145€ me vendime të Qeverisë nr. 14/106 dhe transferit të brendshëm të buxhetit në kategorinë e mallra dhe shërbimeve prej 65,000€. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 83% e buxhetit. Pjesa e mbetur e buxhetit nuk ishte realizuar në plotësi për shkak se faturat e avokatëve për Mbrojtjen Juridike të personave potencialisht të akuzuar në Dhomat e Specializuara kishin ardhur pas përfundimit të vitit fiskal; dhe

- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 244,869€, si rezultat i kursimeve buxhetore nr. 14/106 dhe 01/117, ky buxhet ishte realizuar në masën prej 84%. Në këtë nivel të realizimit kanë ndikuar anulimi i proceseve të prokurimit, pritjet e lejeve ndërtimore nga komunat përkatëse si dhe procesit të ri-tenderimit.

Nga pako për Rimëkëmbje ekonomike (0098) ishin shpenzuar 45,107€ në kategorinë e pagave dhe mëditje të cilat ishin për shtesat e Covid-19 për profesionistët shëndetsor dhe stafin mbështetës.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga MD në 2022 ishin në vlerë 1,085,091€. Të hyrat realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të Gjykatave, nga provimi i Jurisprudencës dhe noterisë dhe nga kompensimet e dëmeve nga kompania e sigurimeve. Bazuar në vitin e kaluar shohim një rritje të inkasimit të konsiderueshme të të hyrave për 749%, kjo për shkak të rritjes së të hyrave nga konfiskimet në fund të vitit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	203,062	203,062	1,085,091	127,803	78,244
Të hyrat jo tatimore	203,062	203,062	1,082,012	127,803	78,244
Të hyrat tjera	0	0	3,079		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Ministrisë së Drejtësisë ka rezultuar në 3 (tri) rekomandime. MD kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria për vitin 2022 po ashtu kishte përgatitur një raport periodik për progresin në zbatimin e rekomandimeve ku janë paraqitur veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, një (1) rekomandim është adresuar, ndërsa dy (2) rekomandime janë adresuar pjesërisht.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministrja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që mangësitë dhe gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2022. Pasqyrat financiare të mos dorëzohen në Thesar-MFPT para se t'i nënshtrohen një rishikimi të detajuar nga ana e menaxhmentit.	Në pasqyrat financiare të vitit 2022 ishte bërë shpallje e saktë e detyrimeve kontigjente, ndërsa gjatë auditimit të pasurive edhe këtë vit kemi hasur në mbivlerësim të pasurive. Më gjerësisht, shih Çështjen C1.	Pjesërisht i zbatuar

2.	Investimet kapitale	Ministrja në bashkëpunim me SHKK-në duhet të sigurojë se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse e projekteve të filluara dhe të ndërmirren veprimet e nevojshme për të siguruar realizimin e projekteve të ardhshme sipas planit kohor të përcaktuar me kontratë.	Nga mostrat e testuara të projekteve kapitale të SHKK-së nuk kemi hasur vonesa në përfundimin e projekteve kapitale.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që komisionet për inventarizimin dhe vlerësim të pasurisë të përfundojnë punën e tyre para përgatitjes së pasqyrave financiare si dhe të bëjnë krahasimin e të dhënave si rezultat i inventarizimit me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël. Mungesat, tepricat, pasuritë e dëmtuara duhet t'i prezantojë në raport dhe të njëjtin duhet ta aprovoj menaxhmenti në mënyrë që ndryshimet të reflektohen edhe në regjistrat kontabël duke përfshirë edhe zhvlerësimin e akumuluar.	Gjatë auditimit edhe këtë vit kemi hasur në mungesën e harmonizimit të raportit të inventarizimit të pasurisë me regjistrat të pasurisë, ndërsa komisionet përkatëse të vlerësimit kishin përfunduar raportet e tyre me kohë. Në vitin 2022 sistemi E-pasuria është funksionalizuar dhe zhvlerësimi i pasurisë ishte llogaritur, mirëpo një pjesë e pasurisë nuk ishte regjistruar në systemin E-pasuria dhe zhvlerësimi ishte kryer manualisht. Për më tepër shih Çështjen C2.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Nora Rashiti, Udhëheqëse e ekipit



Astrit Bllaca, Anëtar i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Kabineti i Ministres të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Data: 19 prill 2023

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.